



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE  
THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Dep. 06  
Nr. Prot. 882123  
Br. Prot. 882123  
Data 15.05.2023  
Nr. Page. 02  
Date PRISHTINË

<b>DATË/A:</b>	12.05.2023
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPKI-06-283/23
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Nexhat Emmini, Hetues – NJHF – Sektori për Hetime Financiare - DHKEK
<b>CC:</b>	Fatmir Karaliti, Shef i Sektorit për Hetime Financiare – DHKEK Antigona Obertinea, Shef i NJHF-SHF/DHKEK/DPP, Prishtinë
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	z. Yll Buleshkaj, Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Esad Ejupi, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion për shqyrtimin e rastit të konfliktit të interesit

I nderuari z. Emmini,

Në mbështetje të nenit 21, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5, të Ligjit nr. 06/L-011 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Agjencia në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë të saj ligjore, ofron këshillim për zyrtarët të lartë të veçantë, udhëheqësve, institucioneve udhëheqëse, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, përfshirë këshillime të veçanta për personat zyrtarë sipas këtij ligji pasi të jenë shteruar mjetet e brendshme në institucionet punëdhënëse dhe kur gjykohet e domosdoshme përfshirja e Agjencisë.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të kërkesës tuaj me nr.DHKEK-P-59-2023, ka filluar procedurën për shqyrtimin e mundshëm të konfliktit të interesit, lidhur me pretendimin të cilin e keni shkruar në kërkesë dhe atë si në vijim;

“Nëse një zyrtar në pozitë aktuale Menaxher në Departamentin e Postës Hibrade në Ndërmarrjen Publike “Posta e Kosovës Sh.A, a ka të drejtë që njëkohësisht të emërohet dhe ushtroj pozitën e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike “Telekomi i Kosovës” Sh.A”.

Agjencia, lidhur me pretendimin tuaj, ka kërkuar dhe pranuar dokumentacion e nevojshëm nga “Posta e Kosovës” Sh.A.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës është konstatuar gjendja faktike si në vijim;

Zyrtar i lartë publik sipas Ligjit nr.06/L-011 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit konsiderohen zyrtarët e lartë publikë të përcaktuar sipas Ligjit përkatës për deklarimin, kontrollin dhe prejardhjen e pasurisë.

Funksioni Menaxher i Postës Hibride në 'Posten Kosovës' Sh.A, nuk hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik sipas Ligjit nr.08/L-108 Për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave. Menaxheri i Postës Hibride i raporton Drejtorit të shërbimeve Postare.

Edhe sikur kjo pozitë e zyrtarit në fjalë, të ishte pozitë e zyrtarit të lartë publik, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nuk e ndalon ushtrimin e këtyre dy funksioneve, por ka kufizimin si vijim;

2. "Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të".

Agjencia për parandalimin e Korrupsionit, duke u bazuar në përgjegjësit e përcaktuar në Ligjin nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, konstaton se ushtrimi i funksionit Menaxher i Postës Hibride në "Postën e Kosovës" Sh.A dhe njëkohësisht Kryesues i Bordit në Ndërmarrjen Publike "Telekomi i Kosovës" Sh.A, nuk paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, kjo për faktin se Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit nuk ka përcaktuar ndonjë dispozitë kufizuese lidhur me pretendimin e ngritur në Agjenci.

Agjencia është autoriteti qendror përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ju falënderon për bashkëpunimin.